



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 99, Datë 09.04.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“KOKA & ERGI ENERGY PESHK” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 990/1 prot., datë 08.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 990 prot., datë 26.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “a”, dhe pikën 2.5.
- Në këtë aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të përfshijë në objektin e veprimtarisë së saj dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe të depozitojë ekstraktin historik të regjistrit tregtar të përditësuar.
- **gërma “b”:** Duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për një nga administratorët e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të saj për dedikimin e shumës të nevojshme për të mbuluar të paktën e një 1 muaji të aktivitetit të tregtimit.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI